

Bazuar në nenin 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 i Rregullores për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (tekst i pastruar) nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në seancën e 21-të mbajtur më 27.05.2022, në lidhje me Propozimin nr 603-2071/3 nga 25.05.2021, për marrjen e procedurës kundërvajtëse ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçov për shkelje të nenit 92 paragrafi 1 nga LSHMAAV, miratoi si më poshtë:

## K O N K L U Z Ë

1. Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.10-2071/1 nga 20.05.2022 ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçov dhe përcaktoi shkelje të nenit 92 paragrafi 1 nga LSHMAAV.

2. Këshilli konkludoi se ndaj SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçov të inicohet procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi i përmendur më 9 maj 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% program të prodhuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që është në kundërshtim me nenin 92 paragrafi 1 nga LSHMAAV.

3. Obligohet sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesë për marrjen e procedurës kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente për transmetuesin e përmendur.

4. Ekzemplar nga konkluzioni t'u dorëzohet:

- Udhëheqësve të sektorëve në Agjencion,  
[REDACTED] Personit të emëruar nga Agjencia, për udhëheqjen e lëndëve në procedurën administrative,
- Sektori për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë,
- Sektori për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme-arkivi i Agjencisë.

**Nr. 02-2108/3**  
**27.05.2022**  
**Shkup**

**Agjencia për shërbime mediatike**  
**audio dhe audiovizuele**  
**Kryetar i Këshillit**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**